

NDIHMA JURIDIKE PËR JU

LISTA E ADRESAVE TË ZYRAVE RAJONALE PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Prishtinë : Zyra Qëndrore: Rr. "Zenel Salihu" nr. 30; Tel. 038 200 18 942

Prishtinë : Rr. "Zenel Salihu" nr. 30; Tel. 038 200 18 945

Prizren : Rr. "Marin Barleti" nr. 11 ; Tel. 029 230 554

Pejë : Rr. "Bukureshës" nr. 8; Tel. 039 423 698

Mitrovicë: Sheshi "Isa Boletini" Nr.27, Mitrovicë; Tel. 028 534 477

Gjilan : Rr. " Marije Shllaku" Pn. Gjilan: Tel. 0280 321 134

AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

KATALOG



NORWEGIAN EMBASSY

"Përkrahuar nga Ambasada e Norvegjeze"

0800 11 777 / falas
www.anjf-rks.org



NDIHMA JURIDIKE | PRAVNA POMOC
LEGAL AID

Ndihma juridike falas

- nëse keni probleme nga marrëdhënia familjare,
- nëse keni çështje të pazgjidhura pronësores juridike,
- nëse keni probleme nga marrëdhënia e punës,
- nëse dikush është në marrëdhënie detyimore me ju,
- nëse keni kërkesa që duhen të zgjidhen te organet administrative,
- nëse duhet të zhvilloni procedurë gjyqësore, ose dikush po zhvillon procedurën gjyqësore kundër jush,
- nëse jeni të arrestuar apo të paraburgosur,

Ju keni nevojë për ndihmë juridike falas, që ofrohet në zyrat e ndihmës juridike, nga zyrtarët, dhe nga avokatët të angazhuar prej zyrave të ndihmës juridike.

Çka nënkupton e drejta për ndihmë juridike?

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ju mundëson të përfitonit nga ndihma juridike falas, duke ju ofruar shërbime profesionale juridike, në :

- Informata dhe këshilla juridike lidhur me procedura ligjore
- përpilimin e shkresave dhe tërë ndihmën tjetër teknike që ka të bëjë me kompletimin e lëndës
- përfaqësimin në procedurën civile, penale administrative dhe kundërvajtje

- mbrojtjen dhe përfaqësimin në të gjitha fazat e procedurës penale
- informata dhe këshilla juridike lidhur me procedurat kundërvajtëse.
- Informatat, këshillat juridike dhe ndihma në procedurat e ndërmjetësimit, arbitrazhit

Kush ka të drejtë për ndihmë juridike falas?

Në qoftë se jeni në gjendje materiale që ju bën të pamundur të zgjidhni problemin tuaj, dhe nuk mundeni të angazhoni avokatin privatisht, sepse

- nuk i realizoni të ardhurat
- jetoni nga ndihma sociale
- jeni pensionist
- i realizoni të hyrat mujore me të vogla se të ardhurat mesatare në vend

Ju e përmbushni kriterin financiar, për të përfitur nga ndihma juridike falas.

Çka pastaj?

I drejtoheni zyrës më të afërt për ndihmë Juridike falas, e paraqitni problemin tuaj juridik, dhe nëse kërkesa e juaj është e bazuar me Ligjin për Ndihmë Juridike Falas Nr. 04/L-017, ju plotësisht jeni të kualifikuar që të përfitonit nga ndihma juridike falas.

Ku do të realizoni të drejtën për ndihmë juridike falas?

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, ka 13 zyra për ofrimin e ndihmës juridike falas, në vende të cilat lehtë mund të identifikohen dhe të gjenden, me adresat dhe numrat e telefonave (shikoje faqen e fundit)

Kush do t'ju udhëzoj për realizimin e të drejtës tuaj?

Në zyrat e ndihmës juridike, punojnë nga dy jurist dhe nga një asistent administrativ, të cilët pasi që njoftohen me problemin tuaj juridik, e plotësojnë aplikacionin, dhe varësisht nga kriteret dhe natyra e problemit juridik, lëshojnë vendim për lejimin apo refuzimin e ofrimit të ndihmës juridike falas. Aplikacionit i bashkëngjiten të gjitha dokumentet e nevojshme për realizimin e të drejtës për ndihmë juridike falas, (dokumentet personale si dhe dokumentacionin mbështetës, me të cilin dëshmoni gjendjen financiare dhe statusin tuaj shoqërorë).

E drejta për t'u ankuar kundër vendimit për refuzimin e ndihmës juridike falas

Në rast se ju refuzohet ndihma juridike falas, ju keni të drejtë që të ushtroni ankesë kundër vendimit mbi refuzimin e ndihmës juridike falas. Ankesa i paraqitet Komisionit për Ankesa në afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimit të vendimit mbi refuzimin e ndihmës juridike falas. Komisioni e shqyrton ankesën tuaj, dhe vendos në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të ankesës.

Kush i paguan shpenzimet për realizimin e të drejtës tuaj?

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ju mundëson që të përfitonit nga shërbimet profesionale juridike, të ofruara nga ana e zyrtarëve, apo nga avokatët e angazhuar. Këto shërbime janë falas dhe ju nuk paguani për veprimet juridike të tyre.

Të drejtat tuaja lidhur me ndihmën juridike falas

Në qoftë se për realizimin e të drejtës tuaj zhvillohet procedura gjyqësore, ju liroheni nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore.

Obligimet tuaja me rastin e aplikimit për ndihmë juridike falas

1. Dhënia e shënimeve të sakta për gjendjen materiale

Me rastin e aplikimit për ndihmë juridike falas ju keni për obligim që të ofroni të dhënat e sakta, për gjendjen tuaj materiale. Në qoftë se zbulohet se keni dhënë shënime të rrejshme, gjatë kohës së përfitimit të ndihmës juridike falas, atëherë ajo ndihmë do të ndërpritet menjëherë. Njëkohësisht Ju do të obligoheni që t'i kompensoni të gjitha mjetet e shpenzuara për rastin tuaj.

2. Informimi lidhur me ndryshimin e gjendjes materiale

Në qoftë se gjatë përfitimit të ndihmës juridike falas, sidomos gjatë udhëheqjes së procedurës gjyqësore, gjendja e juaj materiale përmirësohet, jeni të obliguar të njoftoni zyrën për ndihmë juridike, e cila e udhëheq rastin tuaj, në mënyrë që të rishqyrtohet çështja e kualifikimit tuaj për ndihmë juridike falas.

3. Kthimi i mjeteve materiale, me rastin e zgjidhjes së suksesshme të çështjes

Në qoftë se fitoni procedurën gjyqësore, shpenzimet gjyqësore të cilat bien në barë të palës së kundër, duhen të derdhen në xhirollogarinë e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në shumë që vlerësohet nga gjykata.

Ndihma juridike në çështje penale

• Ndihma juridike falas e menjëhershme

ofrohet për të gjithë personat e arrestuar apo të ndaluar në polici, pavarësisht përmbushjes së kriterëve të cilat kërkohen në Ligjin për Ndihmë Juridike Falas Nr. 04/L-017,

Fshehtësia e informacioneve

Ofruesit e ndihmës juridike, janë të obliguar që të mbajnë në fshehtësi strikte të gjitha informatat që i kanë marrë me rastin e aplikimit të aplikuesëve të ndihmës juridike, të cilëve u është ofruar ndihma juridike falas, ose janë përfaqësuar nga avokati. Përrjashtim bëjnë rastet kur zbulimi i tyre është bërë me pëlqimin e përfituesit, apo kur kërkohet me ligj.